



KONTRATE SHITJEJE –TRANSFERIM AKSIONESH

Sot me 11.04/2003, ne zyren e Noterise Tirane, me seli ne Rrugen e Durrësit , perpara meje Noterit Publik Artemisa Meçaj u paraqiten personalisht te meposhteshenuarit :

a) **SHITESI**

MERITA ALIU ,e bija e XHELALIT lindur ne Tirane me 05.01.1969 , banues ne rrugen Bajram Curri 496 , shtetase shqiptare , poseduese e pasaportes nr.0372063, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, aksionere e Shoqerise Tregetare “ATLANTIK “SH.A., zoteruese e 200 aksioneve qe perbejne 2% (dy) te numrit total te aksioneve te kesaj Shoqerie.

b) **BLERESI**

DRITAN ÇELAJ, i biri i RRAPOS, lindur ne Berat, me 27.08.1968, banues ne Vlore, lagja Pavaresia, nr. 107, posedues i pasaportes nr. 1727675, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, aksioner i Shoqerise Tregetare “ATLANTIK “SH.A., zoterues i 93.1% te aksioneve te kesaj Shoqerie , e barabarte me 9310 aksione ,

te cilet me kerkuan hartimin e kesaj kontrate shitje (transferim) aksionesh, ne baze te ligjit 7638, date 19.11.1992 “Per Shoqerite Tregetare”, neni 705 i Kodit Civil, ligji 8081 date 07.03.1996 “Per veprimtarite e sigurimeve dhe risigurimeve”.

Shoqeria Tregetare “ATLANTIK “SH.A. eshte themeluar dhe eshte njohur si Person Juridik ne baze te vendimit te Gjykates se rrethit Tirane nr. 25720 date 02.05.2001 .

Kapitali themeltar i kesaj shoqerie ne momentin e themelimit, pasqyruar ne Akt Themelim dhe Statutin e kesaj shoqerie , rezulton 100.000.000Leke (njqindmiljon leke), i perbere nga 10.000 aksione nominale, me vlere nominale 10.000 leke, ne te cilen aksioneret marrin pjese si me poshte

MERITA ALIU zoteruese 2% (dy) te aksioneve te kesaj Shoqerie , e barabarte 200 aksione,

DRITAN ÇELAJ, zoterues i 93.1% te aksioneve te kesaj Shoqerie , e barabarte me 9310 aksione, qe perbejne 93.1% te numrit total te aksioneve,

DERVISH HASKAJ, zoterues i 4.9 % te numrit total te aksioneve te kesaj Shoqerie te barabarta me 490 aksione.

Me vendim nr. 269.. Date 10/04/03 te Asamblese se Pergjithshme te Aksionereve eshte miratuar shitja e aksioneve ne pronesi te MERITA ALIUT , dhe blerjen e tyre nga aksioneri i po kesaj shoqerie DRITAN ÇELAJ.

Pala e pare, Shitesja MERITA ALIU , deklaroi se eshte pronare dhe zoteron pa asnje pengese sasine e aksioneve qe pershkruhen hollesisht me siper, ne shoqerine anonime me emrin Shoqeria Tregetare "ATLANTIK "SH.A. me seli ne Tirane, Shqiperi

MERITA ALIU deklaroi me vullnet te lire dhe te plote se bazuar ne te drejten qe buron prej tyre ,dhe te drejten qe ajo ka mbi to, ia shet keto aksione zotit Dritan Çelaj duke transferuar ne kete menyre 2% te numrit total te aksioneve te kesaj Shoqerie te barabarta me 200 aksione, kundrejt cmimit te shitjes prej 6.000.000 leke (gjashte milion leke), duke ja kaluar ne pronesi dhe zoterim te plote , karshi shumes se blerjes te gjitha te drejtat dhe detyrimet, aktivin dhe pasivin, qe buron nga ky kapital , bleresit DRITAN ÇELAJ.

Per shumen prej 6.000.000 leke (gjatemiljon leke) , bleresi deklaroi se e ka shlyer plotesisht jashte kesaj zyre,se ajo i pergjigjet vleres se aksioneve te transferuara dhe se shitesi pranon se i ka marre keto leke nga bleresi .

Pas nenshkrimit te kesaj kontrate shitjeje "shitesja" MERITA ALIU pranon dhe deklaroi se heq dore nga cdo titull dhe e drejte lidhur me zoterimin e aksioneve te siperpermendura dhe njeh dhe emeron "bleresi" DRITAN ÇELAJ si te vetmin pronar dhe zoterues te atyre aksioneve, dhe ai qe tani eshte i lire te veproje , konform ligjit.

"Shitesi", nepermjet ketij dokumenti, kontrate shitje aksionesh, garanton si me poshte:


1)Te gjitha aksionet e lartpermendure te "shoqerise", dhe te transferuara , jane te lira nga cdo barre ,huamarje, konfiskim, pretendime personash te trete, apo dyshime , gjithashtu garanton aksionet te lira nga cdo detyrim ligjor.

2)Te gjitha aksionet e siperpermendura te "shoqerise", jane shpallur dhe nenshkruar konform ligjit dhe vlere e tyre eshte reale dhe e kontrollueshme.

3)Kapitali themeltar i kesaj shoqerie dhe pas nenshkrimit te kesaj kontrate shitje mbetet ai qe ishte ne momentin e themelimit , pasqyruar ne Akt Themelim dhe Statutin e kesaj shoqerie, 100.000.000Leke (njqindmiljon leke), i perbere nga 10.000 aksione nominale, me vlere nominale 10.000leke secili.

4) "Shoqeria" deri ne daten e sotme vepron normalisht branda kuadrit ligjor dhe nuk eshte objekt ndalimesh apo anullimesh nga gjykata e Tiranes, nga e cila u miratua , bazuar ne statut dhe ne aktin e themelimit.

5) "Shitesi" kalon tek " Bleresi" teresisht 200 aksione te cilat perbejne 2% te numrit total te aksioneve te shoqerise
"Bleresi" deklarone se ju vune ne dispozicion te tije , per studim dhe kontroll, te gjitha librat ekonomke dhe te bilancit te "shoqerise" .



Pas nenshkrimt te kesaj kontrate bleresi DRITAN ÇELAJ behet pronar, zoterues i 95,1 % te aksioneve te kesaj Shoqerie , e barabarte me 9.510 aksione, dhe shitesi MERITA ALIU nuk ka me asnje lloj te drejte mbi aksionet e kesaj shoqerie.

Aksioneret dhe pjesemarrja e tyre ne kapitalin themeltar pas nenshkrimt te kesaj kontrate eshte si me poshte :

1*DRITAN ÇELAJ, zoterues i 95.1% te aksioneve te kesaj Shoqerie, e barabarte me 9510 aksione ,

2*DERVISH HASKAJ, zoterues i 4.9 % te aksioneve te kesaj Shoqerie , e barabarte me 490 aksione ,

Nje kopje e kesaj kontrate do te depozitohet ne zyren e regjistrimit tregetar ne Tirane, dhe do te behen pasqyrimet perkatese te ndryshimeve te mesiperme.

Konform me sa me siper u hartua ky dokument , kontrate shitblerje aksionesh, ne gjashte (6) kopje origjinale , dhe mbasi u lexua, u binden palet per permbajtjen, u firmos nga te dy(2) palet ne kontrate dhe secili prej tyre morri nga nje kopje origjinale, dhe une noterja vertetoj Kontraten e Shitjes se Aksioneve konform ligjit.

SHITESI I AKSIONEVE

Merita Aliu
MA

BLERESI I AKSIONEVE

Dritan Celaj
DC

NOTERI PUBLIK

